REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1777/1 Prot. Vlorë, më, 02.11.2020

VENDIM

Nr. 101, datë 31.10.2020

MBI NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 92, DATË 21. 10. 2020 "PËR SHQYRTIM DHE MIRATIMIN E PROPOZIMEVE PËR MËNYRAT E ZHVILLIMIT TË PLANIT MËSIMOR PËR VITIN AKADEMIK 2020- 2021 NË KUSHTET E PANDEMISË COVID- 19"NË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË

Në mbështetje të nenit 38 pika1 shkronja f të Ligjit Nr.80/2015 *"Për arsimin e lartë dhë kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"*, nenit 19 të Statutit të Univcersitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Senati Akademik në mbledhjen online të datës 31. 10. 2020,

VENDOSI

1. Procesi mësimor në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë për vitin akademik 2020 - 2021 nis në datën 02. 11. 2020.
2. Ndodhur në kushtet e pandemisë Covid- 19, procesi mësimor, gjatë muajit Nëntor, në rubrikat leksione dhe seminare, do të zhvillohet online përmes platformës Google Classroom dhe aplikacionit Google Meet.
3. Grupe të vogla dhe të reduktuara studentësh, me kërkesën e tyre, mund të ndjekin elemente të procesit mësimor (laboratore, seminare, konsultime etj) edhe me prezencë fizike në auditore, duke respektuar rigorozisht protokollet e sigurisë për COVID- 19.
4. Praktikat profesionale për studentët e programeve të studimit të FSH, do të zhvillohen normalisht në spitalet rajonale apo bashkiake të vendbanimeve të tyre.
5. Autoritetet drejtuese, stafi akademik, stafi ndihmës akademik me karakter administrativ dhe stafi administrativ i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, pavarësisht zhvillimit online të procesit akademik do të respektojnë orarin zyrtar në institucion. Stafi akademik pas zhvillimit të mësimit online (jashtë apo në ambjentet e institucionit) duhet të zhvillojë dhe veprimtaritë e tjera të përditshme në institucion duke respektuar orarin zyrtar.

6. Stafi akademik do ta zhvillojë procesin mësimor online kryesisht në ambjentet akademike të fakulteteve përkatëse ose, në raste pamundësish objektive, mund ta kryejë procesin mësimor në mjedise të tjera të përshtatshme për ta.
7. Autoritetet drejtuese të njësive bazë dhe kryesore, përgjegjësit e grupeve mësimore, koordinatorët e studentëve dhe gjithë personeli akademik i UV të marrin masa të veçanta me qëllim që studentët e viteve të para të njihen me rregullat e funksionimit të procesit mësimor në programin e studimit ku janë regjistruar, si dhe të njihen me procedurat e zhvillimit të procesit të mësimdhënies në distancë.
8. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi të gjitha strukturat akademike, ndihmësakademike dhe administrative të UV.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORË